

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 352/1 Prot.

Shkodër, më/3.05.2023

Lënda: Mbi Vendimin nr. 39, datë 28.04.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 27, pika 6, neni 54, shkronja "n", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 30, pika 4, shkronjat "b" dhe "c", të ligjit nr. 9693 "Për fondin kullosor", neni 26, shkronja "c", të ligjit "Për mbrojtjen civile", neni 30, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, të VKM 1080, datë 22.12.2010 "Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota", të shkreses së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 2902 prot., datë 04.05.2023 "Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të datës 28.04.2023", shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 39, datë 28.04.2023 "Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor e kullosor për vitin 2023".

Për sa trajtuar më sipër, Prefekti ju autorizon procedimin e mëtejshëm duke zbatuar edhe kriteret e parashikuara nga neni 30, të ligjit nr. 45/2019.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGONI






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 39 datë 28.04.2023



Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin Pyjor e Kullosor per vitin 2023

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 28.04.2023, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, Bazuar në Ligjin Nr.57/2020, datë 30.4.2020: “Për Pyjet”, neni 30, pika c; Ligjin nr Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin Nr. 9693, datë 19.3.2007: “Për fondin kullosor” i ndryshuar. Ligji Nr. 10 431, datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”; Ligji Nr. 152, datë 21.12. 2015 “Për sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi”; ligjit nr 45, date 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile”; VKM 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat per parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, me shumicë votash:

V E N D O S I

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin Pyjor e Kullosor për vitin 2023.
2. Ngarkohen Drejtoria e Pyjeve, dhe Turizmit dhe mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R Y E T A R
MARK BISHA

Sekretari i Këshillit Bashkiak
ARDIAN ÇELEPIJA

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 03.05.2023